



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



01.Nr. 104/02-25056/22
Kačanik, 25.08.2022

Republika e Kosovës, Komuna e Kaçanikut, në bazë të neni 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, të nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunes merr këtë:


VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR ZHVILLIMIN E “DATABAZËS”

1. Me këtë vendim formohet grupi punues për zhvillimin e një “databaze”-bazë të dhënash për të përcaktuar në mënyrë efektive akterët dhe organizatat që përfaqësojnë interesat e grupeve të ndryshme qytetare në Komunën e Kaçanikut në përbërje si në vijim:
 - Bejtullah Dalloshi- Zyra e Kryetarit
 - Valdrin Dogani- DKRS
 - Murat Burrniku- DAP
 - Hasan Zharku - DA
 - Gafurr Loku-DSHMS
 - Avdi Verbani-DSHMS
 - Fatlume Selimi-Zyra për Informim
 - Vedat Dema- Zyra për Barazi Gjinore
 - Fadil Guri-Zyra për Komunitete
 - Fatmir Çaka –OJQ
2. Drejtoritë tjera në nivel të komunës që nuk janë të përfshira direkt në Grupin Punues, janë të obliguara të mbështesin procesin e punës në identifikimin e grupeve qytetare si dhe në popullimin e bazës së të dhënave.
3. Detyrat e anëtarëve të grupit punues janë: Zhvillimi, popullimi dhe menaxhimi i databazës, e cila do të lehtësojë procesin e konsultimeve publike si dhe do të ndihmojë në përfshirëjen më të madhe të grupeve të ndryshme qytetare në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.
4. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset: Kryetari i Komunës.
6. Vendimi i dërgohet Kryetarit të Komunës, anëtarëve të grupit punues dhe arkivit të komunës.

Kryetari i Komunës:

z.BESIM ILAZI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/02-20039/22
Kaçanik, 20.08.22

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, pas propozimit të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, kryetari i komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e grupit teknik për projektin "Pilotimi i Kompostimit në Shtëpi në 6 komunat e Kosovës".

- I. Me këtë vendim formohet grupi punues teknik për implementimin e projektit "Pilotimi i Kompostimit në Shtëpi në 6 komunat e Kosovës", (MoU) ndërmjet Komunës së Kaçanikut si përfutuese e projektit të "Shërbimet e Qëndrueshme Komunale (menaxhimi i mbeturinave)" GIZ, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Organizatës Joqeveritare Green Art Center-Prishtina (GAC).
- II. Grupi punues teknik, do të ketë këtë përbërje:
 1. Ramadush Osmani - drejtor i DSHPE -së;
 2. Afrim Fuga - zyrtar për menaxhimin e mbeturinave;
 3. Bujar Dullovi - inspektor mjedisor;
 4. Xhelal Ceka - udhëheqës i K.R.M "Pastërtia" njësia në Kaçanik;
 5. Muharrem Baftiu-zyrtar në K.R.M "Pastërtia" njësia në Kaçanik
 6. Ardiana Tusha - shoqëria civile - KVRI.
- III. Grupi punues teknik është i obliguar që të bashkëpunojë ngushtë në të gjithë procesin e implementimit të marreveshjes me OJQ "Green Art Center - Prishtina" (GAC) duke ofruar kapacitetet e veta teknike dhe profesionale.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
- V. Me këtë vendim, njoftohen: Anëtarët e grupit punues dhe Arkivi.

Besim Ilazi

Kryetari i Komunës

